MAQEDONIA E VERIUT - RAPORTI NDËRKOMBËTAR PËR LIRITË FETARE - 2019

Përmbledhje e shkurtër

Kushtetuta ndalon diskriminimin fetar dhe parashikon lirinë e besimit dhe shprehjes fetare. Ajo siguron barazi para ligjit për të gjithë individët pavarësisht besimit fetar. Në kushtetutë janë përmendur me emër pesë grupe fetare që automatikisht lirohen nga taksat dhe që kanë përfitime të tjera. Grupet e tjera fetare duhet të regjistrohen për përfitime të barasvlefshme. Aplikimet për regjistrim nga Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit (KOO) dhe Komuniteti Bektashian (Tetovë) mbetën pezull në Gjykatën Themelore të Shkupit II, pas një raporti të Komisionit Evropian (KE) që i bëri thirrje qeverisë të përshtatet me vendimet e mëhershme të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) dhe që qeveria duhet ta rishqyrtojë refuzimin e saj të mëparshëm të aplikimeve të këtyre grupeve. Komuniteti Bektashian (Tetovë), një komunitet sufist, përsëri raportoi ngacmime të anëtarëve të saj nga qeveria dhe Bashkësia Fetare Islame në Maqedoninë e Veriut (BFI). BFI deklaroi se qeveria vazhdoi favorizimin e Kishës Ortodokse Maqedonase-Arqipeshkvisë së Ohrit (KOM-i), ndërsa grupet më të vogla fetare vazhduan të raportojnë trajtim të pabarabartë nga ana e qeverisë krahasuar me pesë grupet e përmendura në kushtetutë. Në muajin prill, pasi Gjykata Themelore e Shkupit II njohu një imam të cilin BFI-ja nuk e pranonte si udhëheqës të saj, BFI-ja akuzoi zyrtarët e qeverisë për një "përpjekje për grusht shteti" dhe e ankimoi aktvendimin në Gjykatën e Apelit në Shkup, e cila në tetor ia ktheu lëndën gjykatës themelore. Gjykata themelore menjëherë e ndryshoi vendimin e saj të mëparshëm, duke lënë në fuqi udhëheqësinë ekzistuese të BFI-së.

Në shtator persona të panjohur u përpoqën të sulmojnë themeluesin e Komunitetit Fetar të Shqiptarëve Ortodoksë, i cili për këtë e fajësoi qeverinë se kishte qenë joefikase në hetimin e një sulmi të mëparshëm. Policia deklaroi se ka akuzuar gjashtë persona për raste vjedhjesh, zjarrvënieje, ose akte vandalizmi ndaj objekteve fetare, por që nuk i kishte identifikuar autorët e një tjetër tentative për t'i vënë zjarrin një kishe në pronësi të Kishës Ungjillore. KOM-i raportoi 12 incidente vjedhjesh dhe një tentativë për t'i vënë zjarrin njërës prej kishave të saj, ndërsa qeveria raportoi dy incidente të vandalizmit kundër varrezave ortodokse; krahasuar me 26 akte vjedhjesh ose vandalizmi të vendeve ortodokse në vitin 2018.

Qeveria raportoi edhe për një vjedhje në xhami. Komuniteti Bektashian (Tetovë) vazhdoi të kundërshtojë pretendimet e BFI-së për pronësinë e plotë teqenë Harabati Baba, si dhe planet për ta rinovuar këtë kompleks, të cilin Bektashinjtë e Tetovës e kanë përdorur si selinë e tyre.

Ambasadori dhe zyrtarë të tjerë të ambasadës amerikane janë takuar me përfaqësues të qeverisë për të diskutuar çështjet e lirisë fetare, duke përfshirë përmirësimin e bashkëpunimit ndërfetar si dhe respektimin dhe trajtimin e barabartë nga ana e qeverisë të grupeve fetare. Sekretari amerikan i shtetit gjatë vizitës së tij në muajin tetor u takua me Kryepeshkopin e KOM-it Stefan dhe dy peshkopë të KOM-it. Zyrtarë të ambasadës u takuan me përfaqësues të shumtë të pakicave fetare, duke përfshirë bektashinjtë, hebrenjtë dhe anëtarët e kishave të vogla krishtere, si dhe me organizata joqeveritare (OJQ) që merren me çështje të lirive fetare. Ambasada mbështeti përpjekjet për edukimin mbi Holokaustin dhe sponsorizoi shoqërinë civile dhe përfaqësuesit fetarë për vizitate tyre në Shtetet e Bashkuara për programe të përqendruara në promovimin e tolerancës fetare.

Pjesa I. Demografia fetare

Qeveria e Shteteve të Bashkuara vlerëson se popullata numëron 2.1 milionë banorë (vlerësim prej vitit 2019). Sipas regjistrimit të fundit shtetëror, të vitit 2002, ka rezultuar se 65% e popullatës është deklaruar se i përket besimit të krishterë ortodoks, ndërsa 33% besimit mysliman. Grupet e tjera fetare, që të gjitha së bashku përbëjnë më pak se 2% të popullsisë, përfshijnë katolikët, emërtimet e ndryshme protestante, Dëshmitarët e Jehovait dhe Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme (mormone). Sipas vetë komunitetit çifut, janë rreth 200 anëtarë të tij.

Shumica e myslimanëve jetojnë në pjesët veriore dhe perëndimore të vendit. Shumica e të krishterëve ortodoksë jetojnë në pjesën qendrore dhe juglindore të vendit. Ekziston një ndërlidhje mes përkatësisë etnike dhe asaj fetare – shumica e të krishterëve ortodoksë janë maqedonas etnikë, ndërsa shumica e myslimanëve janë shqiptarë etnikë. Përveç kësaj, shumica e romëve dhe pothuajse të gjithë turqit dhe boshnjakët janë myslimanë, ndërsa shumica e serbëve dhe vllehëve janë të krishterë ortodoksë. Ekziston edhe një lidhje midis përkatësisë fetare dhe asaj politike pasi partitë politike janë të ndara në linja etnike.

Pjesa II. Gjendja e respektimit të lirive fetare nga ana e Qeverisë

Korniza ligjore

Kushtetuta ndalon diskriminimin fetar dhe siguron barazinë e të drejtave për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga besimi fetar. Ajo garanton lirinë e fesë dhe të drejtën e individëve për të shprehur besimin e tyre lirisht dhe publikisht, në mënyrë individuale ose në mënyra të tjera, garanton identitetin fetar të kombësive dhe komuniteteve në vend. Shteti përmend pesë grupe fetare Kushtetutë - Kishën Ortodokse Maqedonase, Bashkësinë Fetare Islame në Maqedoninë e Veriut, Kishën Katolike, Kishën Metodiste Ungjillore dhe Komunitetin hebre – ndërsa përcakton se pesë grupet fetare të emërtuara, si dhe "grupet e tjera fetare" janë të ndara nga shteti, të barabarta para ligjit dhe të lira të themelojnë shkolla, bamirësi dhe institucione të tjera shoqërore.. Ligji mundëson që organizatat e tjera fetare t'i kenë të drejtat e njëjta dhe statusin ligjor si këto pesë grupe duke aplikuar për njohje nga ana e Qeverisë dhe regjistrim përmes gjykatës. Kushtetuta i ndalon partitë politike apo shoqatat e tjera që të nxisin urrejtje ose jotolerancë fetare.

Ligji i përcakton krimet e urrejtjes si vepra penale kundër një personi fizik, juridik, si dhe personave të tjerë, ose kundër pasurisë së tyre, të kryera për shkak të një karakteristike të vërtetë ose të supozuar, përfshirë kombësinë, origjinën etnike dhe fenë ose besimin e viktimës. Gjuha e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes janë vepra penale të dënueshme dhe mund të rezultojnë me dënime më të rrepta për krime të tjera kur përfshihen elementë të krimit të urrejtjes.

Organizatat fetare mund të kërkojnë të regjistrohen si "kishë", "bashkësi fetare", ose "grup fetar". Këto klasifikime bazohen në madhësinë e grupit, organizimin e brendshëm dhe hierarkinë e brendshme. Sipas autoriteteve gjyqësore, këto tri kategori trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit dhe nuk nënkuptojnë diferencë në të drejtat, përfitimet ose detyrimet ligjore. Qeveria ka njohur 37 organizata fetare, duke përfshirë edhe pesë organizatat e emërtuara në kushtetute. Janë gjithsejt 17 kisha, 9 bashkësi fetare dhe 11 grupe fetare. Pas regjistrimit, një kishë, komunitet ose grup fetar lirohet nga taksat dhe ka të drejtë të aplikojë për kthimin e pronës së nacionalizuar në kohën e komunizmit (me kusht që të kenë ekzistuar në atë kohë), projekte të financuara nga qeveria, si dhe leje ndërtimi për ruajtjen e objekteve të

shenjta dhe kulturore. Gjithashtu, mund të themelojë edhe shkollë. Grupet e paregjistruara mund të mbajnë tubime ose të konvertojnë, por nuk mund të angazhohen në aktivitete të caktuara, siç është themelimi i shkollave ose marrja e donacioneve pa taksë për donatorin, domethënë këto nuk lirohen nga taksat.

Gjykata Themelore Shkupi II i pranon aplikacionet për regjistrim dhe në afat prej 15 ditë pune duhet të vendosë nëse aplikacioni i organizatës fetare i përmbushë kriteret ligjore për regjistrim. Kriteret në fjalë janë: prania fizike administrative në vend; shpjegimi i besimeve dhe praktikave që e dallojnë atë prej organizatave tjera fetare, dhe emri dhe simboli i veçantë zyrtar i grupit. Një organizatë aplikuese duhet gjithashtu të identifikojë një organ mbikëqyrës që kujdeset për menaxhimin e financave të saj, të paraqesë kategorizimin e mjeteve financiare të saj dhe të burimeve të financimit, si dhe procesverbalin e kuvendit themelues të organizatës. Ligji e lejon regjistrimin e më tepër grupeve të fesë së njëjtë. Krerët e regjistruar të grupeve fetare ose përfaqësuesit e grupeve fetare duhet të jenë shtetas të vendit.

Gjykata ia dërgon aplikacionet e aprovuara Komisionit për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupeve Fetare (KMBFGR), një organ qeveritar përgjegjës për nxitjen e bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet qeverisë dhe grupeve fetare i cili i regjistron organizatat në Regjistrin e tij. Nëse aplikacioni refuzohet, organizata mund të parashtrojnë ankesë në Gjykatën Kushtetuese me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në bazë të diskriminimit të të drejtave fetare. Në qoftë se kërkesa refuzohet nga Gjykata Kushtetuese, organizata mund t'i ankohet Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj).

Ligji nuk i lejon grupet fetare të drejtojnë shkolla fillore private fetare, por e parashikon mundësinë në nivel të shkollimit të mesëm dhe më lartë. Shkollat e mesme fetare përdorin plan-programet e tyre dhe nuk i nënshtrohen certifikimit nga Ministria e Arsimit. Nxënësve të shkollave të mesme fetare as nuk u kërkohet dhe as nuk u lejohet të marrin provimin shtetëror të maturës dhe për këtë arsye aktualisht nuk mund të regjistrohen në universitete. Ministria e Arsimit i obligon nxënësit e klasës së gjashtë dhe më lartë ta zgjedhin njërën prej tre lëndëve zgjedhore, dy prej të cilave kanë përmbajtje fetare: Hyrje në religjione dhe Etika në religjion. Sipas përshkrimit të Ministrisë, këto lëndë mbulojnë fenë në mënyrë akademike, jofetare. Me lejen dhe pagat nga Ministria e arsimit, lëndët zakonisht ligjërohen nga priftërinj ortodoksë apo imamë, varësisht nga kërkesat e prindërve dhe nxënësve. Ministria e Arsimit thekson se të

gjithë mësimdhënësit e këtyre lëndëve janë trajnuar nga institucionet e akredituara të arsimit të lartë ku ligjërojnë profesorë të filozofisë ose sociologjisë. Nëse nxënësit nuk dëshirojnë të zgjedhin një lëndë mbi fenë, mund të zgjedhin opsionin e tretë, kultura klasike e qytetërimit evropian.

Të gjithë të huajt që kërkojnë të hyjnë në vend për të kryer aktivitete fetare ose të kryejnë rite fetare, duhet të marrin vizë pune para mbërritjes, një proces që normalisht zgjat rreth katër muaj. KMBFGR mban një regjistër për të gjithë punonjësit e huaj fetarë dhe e ka autoritetin që t'ua miratojë ose refuzojë të drejtën për të kryer punë fetare brenda vendit. Vizat e punës janë të vlefshme për gjashtë muaj, me mundësi vazhdimi edhe për gjashtë muaj të tjerë. Vazhdimësia e vizës është e vlefshme për një vit. Nuk ka kufi për numrin e përtëritjeve të vizave që mund t'i lëshohen një punonjësi fetar. Klerikëve dhe punëtorëve fetarë nga grupe të paregjistruara mund t'u lëshohen viza.

Vendi është palë në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

Praktikat qeveritare

Më 29 maj, KE lëshoi raportin e tij për vitin 2019 mbi vendin, i cili i bëri thirrje qeverisë të zbatojë vendimet e mëparshme të GjEDNJ-së për të respektuar të drejtat e KOO-së dhe Komunitetit Bektashian (Tetovë). Në 2017, pas ankesave nga të dy grupet, GjEDNJ kishte vendosur qëqeveria kishte shkelur Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Liritë Themelore (Konventa) duke refuzuar kërkesën e mëparshme të KOO-së për statusin e grupit fetar. Në vitin 2018, GjEDNJ mori një vendim të ngjashëm për Komunitetin Bektashian (Tetovë). Raporti i KE-së për vitin 2019 përshëndeti vendimin e qeverisë për të rihapur procedurat e regjistrimit dhe për të siguruar kompensim për të dy grupet, në përputhje me Konventën.

Në tetor qeveria i pagoi KOO-së 9.500 euro (10,700 dollarë) në kompensim për dëmet dhe tarifat gjyqësore siç kërkohet nga vendimi i GjEDNJ-së në vitin 2017. Autoritetet e KOO-së deklaruan se qeveria refuzoi të regjistronte grupin, ndërhyri në punën gjyqësore në rastet që përfshinin KOO dhe ushtruan presion mbi KOO-në për të dorëzuar një kërkesë të re për regjistrim me një emër të ri. Në shkurt KOO-ja citoi një letër nga Gjykata Themelore e Shkupit

II , në të cilën kërkohej që KOO të ndryshojë emrin e saj sepse gjykata nuk mund ta dallonte atë nga KOM- KO. Në fund të vitit, aplikacioni i regjistrimit të KOO për vitin 2009, pa ndryshuar emrin, mbeti pezull në Gjykatën Themelore të Shkupit II.

Në qershor qeveria i pagoi Komunitetit Bektashian (Tetovë) 7,000 euro (7,900 dollarë) për dëmet dhe tarifat gjyqësore siç kërkohet me aktvendimin e GJEDNJ-së për vitin 2018, por nuk ndërmori asnjë veprim tjetër. Kërkesa e regjistrimit të grupit nga viti 2010 mbeti në pritje të Gjykatës Themelore të Shkupit II.

Gjatë këtij viti, Gjykata Themelore e Shkupit II nuk ka pranuar asnjë kërkesë të re për regjistrim. Gjykata miratoi në korrik një kërkesë të vitit 2018 nga Ungjilli i Kishës së Krishtit për të ndryshuar regjistrimin e saj nga komunitet në grup. Komuniteti i muslimanëve, i cili ishte refuzuar për regjistrim në vitin 2016, në prill tërhoqi kërkesën të rinovuar pa dhënë shpjegim.

KOO-ja dhe Komuniteti Bektashian (Tetovë) deklaruan që, si komunitete të paregjistruara, vazhdojnë të përballen me diskriminime dhe presione, siç janë mungesa e statusit më të cilin do të lirohen nga taksat, pamundësia për të organizuar shkollat e tyre dhe komentet përçmuese për to në media. KOO vazhdoi të akuzojë qeverinë për paragjykime ndaj saj dhe për mosrespektim të ligjit vendor dhe ndërkombëtar.

Tetë vite me radhë, Komuniteti Bektashian (Tetovë) raportoi policin për ngacmim dhe shqetsim nga individë që okupuan kompleksin Harabati Baba Teqe në Tetovë, si pjesë e një kontesti të vazhdueshëm pronësor me BFI-në. Policia deri në fund të vitit ende ishte duke e hetuar rastin.

Në maj Komuniteti Bektashian (Tetovë) dënoi përvetësimin nga BFI-ja të një parcele toke ngjitur me kompleksin Harabati Baba Teqe. Drejtuesi i Komunitetit Bektashian (Tetovë) Arben Sulejmani deklaroi se qeveria e kishte privuar atë nga prona duke mos lejuar që grupi të regjistrohej si një subjekt fetar, pavarësisht vendimit të favorshëm të GJEDNJ-së në vitin 2018. Myftiu i Tetovës nga radhët e BFI-së në muajin maj njoftoi ndërtimin e dy tregjeve dhe deklaroi se qeveria kishte njohur tokën si vakëf (pronë fetare islame) në vitin 2017 dhe e kishte rikthyer atë në vitin 2018.

MAQEDONIA E VERIUT

Më 17 Prill, Gjykata Themelore e Shkupit II miratoi kërkesën e Skënder Buzakut për ta bërë atë drejtuesin zyrtar të BFI-së. BFI-ja e kishte shkarkuar Buzakun nga udhëheqësia e saj në vitin 2015. Në kërkesën e tij, Buzaku tha se një seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit të BFI-së në mars e kishte zgjedhur atë pas "dorëheqjes së parevokueshme" të Reis Sulejman Rexhepit nga drejtues i BFI-së. Sipas BFI-së, asnjë seancë e tillë e jashtëzakonshme nuk ishte zhvilluar. Udhëheqja e BFI-së e kundërshtoi vendimin e gjykatës në Gjykatën e Apelit Shkup, duke thënë se vendimi i Gjykatës Themelore ishte i bazuar në dokumenta të falsifikuar duke përdorur vulat e BFI-së të vjedhura në vitin 2015. Më 3 tetor, Gjykata e Apelit Shkup vendosi aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Shkupit II dhe të rivendosi lëndën në atë gjykatë. Më 4 tetor, Gjykata Themelore e Shkupit II e ndryshoi vendimin e saj të mëparshëm, duke thënë se Buzaku nuk e plotësonte kërkesën minimale të moshës për t'u bërë udhëheqës i BFI-së dhe konfirmoi Rexhepin si udhëheqës. Në prill, BFI ngriti një kallëzim penal kundër Buzakut, duke thënë se Kryeministri Zoran Zaev dhe Ministri i Brendshëm Oliver Spasovski e mbështetën. Të dy zyrtarët, si dhe drejtori i KMBFGR-it Darijan Sotirovski mohuan përfshirjen e qeverisë. Gjatë një konference për shtyp në tetor, Buzaku akuzoi Rexhepin për shpërdorime dhe larje parash. BFI-ja ngriti akuza për shpifje ndaj Buzakut ditën e nesërme.

BFI përsëri deklaroi se qeveria kishte rikthyer më pak se 30 përqind të pronës së shtetit të sekuestruar para se të fitonte pavarësinë në vitin 1991. Xhamia e Husamedin Pashës në Shtip, e nacionalizuar në vitin 1955, mbeti e kontestuar. Sipas drejtuesve të BFI-së, policia bllokoi hyrjen në xhami dhe ngacmoi pastruesit, duke mos lejuar mirëmbajtjen e objektit, duke i pamundësuar BFI-sëorganizimin e ngjarjeve si dhe duke ia bllokuar procedurat për rikthimin e pronësisë së ligjshme të kompleksit të xhamisë.

BFI deklaroi se qeveria vazhdon me mos aprovimin e lejës së ndërtimit të xhamisë në fshatin etnikisht të përzier Llazhec për shkak të presionit nga banorët. BFI-ja gjithashtu theksoi se qeveria vazhdon edhe me mosaprovimin e lejes për rindërtimin e xhamisë në Prilep, duke e konsideruar atë si monument kulturor nën qeverinë dhe jo nën juridiksionin e BFI-së. Në prill, me mbështetje financiare nga qeveria turke, BFI-ja filloi rindërtimin e Xhamisë së Ali Pashës në Ohër. Komuna lëshoi lejen pas një vonese njëvjecare, siç raportohet pjesërisht për shkak të kundërshtimit të qytetarëve për lartësinë e minares, kurse xhamia u rihap në muajin nëntor.

MAQEDONIA E VERIUT

MAQEDONIA E VERIUT

Në mars, kreu i BFI-së, Rexhepi tha se qeveria favorizon KOM-in duke i dhënë privilegje të posaëme, duke i siguruar pronë publike falas, si dhe duke ia financuar ndërtimin e kishave të reja ortodokse.

Në shtator organizata e vllehëve në Manastir tha që qeveria në vitin 2016 ia transferoi KOM-it pronësinë e Kishës historike vllehe të ndërtuar nga Shën Konstantini dhe Elena, pa pëlqimin e komunitetit, duke privuar kështu organizatën nga pronësia e ligjshme e kishës.

KOM-i deklaroi se Komuna e Strugës ende nuk ka vendosur dhe nuk i eshtë përgjigjur kërkesës, e cila është në pritje që nga viti 2013, për ndërtimin e një kishe ortodokse në fshatin Oktisi.

Grupet të vogla fetare vazhduan të deklarojnë që qeveria i trajtoi ata në mënyrë të pabarabartë dhe favorizoi grupet fetare të përmendura në kushtetutë. Ata thanë që Kryeministri Zaev, Presidenti Stevo Pendarovski dhe zyrtarë të tjerë të qeverisë shpesh takohen vetëm me pesë grupet e njohura me kushtetutë.

Disa grupe fetare, prindër dhe zyrtarë të Ministrisë së Arsimit deklaruan se priftërinjtë dhe imamët e angazhuar për të ligjëruar kurset e hyrjes në religjione dhe etikë shpesh theksojnë praktikën e feve të tyre në vend që të paraqesin një përmbledhje neutrale të besimeve të ndryshme.

Në Sesionin Plenar Ndërkombëtar të Përkujtimit të Holokaustit (IHRA) në Luksemburg në 5 Dhjetor, IHRA pranoi kërkesën e Maqedonisë së Veriut për të ngritur statusin e saj nga vëzhgues në ndërlidhje, hapi i parë për t'u bërë një anëtar i plotë.

Në Mars, Ministria e Arsimit dhe Instituti për Trashëgimi Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve hapën një Departament të Edukimin dhe Hulumtimet mbi Holokaustin. Qëllimet e përcaktuara të departamentit janë mbrojtja e lirisë fetare, promovimi i respektimit të diversitetit fetar dhe inkurajimi i bashkëpunimit ndërfetar si një mjet për të luftuar antisemitizmin.

MAQEDONIA E VERIUT

KBFGR-ja raportoi se ajo lëshoi letra pëlqimesh dhe vizash për të gjithë misionarët dhe klerikët e huaj që paraqitën kërkesa për punë fetare gjatë vitit.Qeveria nuk e financoi udhëtimin e grupeve fetare të regjistruara për arsye fetare, por lehtësoi disa procedura udhëtimi përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme. Kjo përfshin marrjen e vizave Saudite falas për Haxh dhe punë të drejtpërdrejtë me qeverinë Saudite, pasi nuk ka ambasadë Saudite në vend.

Pjesa III Gjendja e respektimit shoqëror të lirive fetare

Në shtator, sipas profesorit Branko Sinadinovski, themeluesi i Komunitetit Fetar të Shqiptarëve Ortodoksë, individë të panjohur u përpoqën ta sulmojnë para shtëpisë së tij në Shkup. Policia ndërhyri për të ndaluar sulmin. Sinadinovski tha se ai ishte shënjestruar disa herë më parë (ai ishte sulmuar në vitin 2018), dhe jeta e tij ishte nën kërcënim sepse ai e kishte deklaruar publikisht veten si shqiptar ortodoks. Sinadinovski tha se ai i atribuoi incidentit të shtatorit mungesës së veprimit efektiv nga Ministria e Brendshme pas sulmit të mëparshëm kundër tij.

Komuniteti Bektashian (Tetovë) vazhdoi të kundërshtojë pretendimet e BFI për pronësi të plotë dhe planifikon ta rinovojë me ndihmën turke, kompleksin Harabati Baba Teqe që Komuniteti Bektashian (Tetovë) e përdor si seli. Përfaqësuesit e Bektashinjve vazhduan të shprehin shqetësime se rinovimi i kompleksit do t'i zhvendoste ata nga kompleksi plotësisht. Bektashinjtë nuk mund të pretendonin për kompleksin një kërkesë pronësie, sepse ata mbetën të paregjistruar. Në fund të vitit, projekti i rinovimit mbeti në pritje deri në përfundimin e fizibilitetit.

Në mars, policia ngriti akuza ndaj një individi me iniciale K.D., sepse kishte vizatuar një kryq nazist (swastika) në muret e ish stacionit policor bullgar, tani një muze përkujtimor i kryengritjes kundër fashizmit, dhe ndërtesave të tjera në Prilep, nën nenin e kodit penal për "dëmtim ose shkatërrimin e objekteve të mbrojtura, trashëgimisë kulturore ose asaj natyrore. " Për shkak se kryesi ishte i mituri, ai u la i lirë me një paralajmërim.

Policia identifikoi dhe akuzoi gjashtë persona për vepra vjedhjeje, zjarrvënieje ose vandalizmi ndaj synimeve fetare gjatë vitit, krahasuar me një në vitin 2018. Të gjashtë ishin në proces

gjyqësor në fund të vitit. MOC-OA raportoi 13 akte të vjedhjes së ikonave, dekoratave të altarit ose parave në kishat ortodokse, dhe qeveria raportoi dy incidente vandalizmi kundër varrezave ortodokse, krahasuar me 26 akte vjedhjesh ose vandalizmi të vendeve ortodokse një vit më parë. Qeveria raportoi gjithashtu një vjedhje në një xhami.

Në janar persona të panjohur u përpoqën të ndiznin kishën Ungjillore në fshatin Çeflik, në Komunën Çeshinovë-Obleshevës. Në fund të vitit, policia nuk kishte akuzuar asnjë të dyshuar.

Në mars një varr në oborrin e një kishe ortodokse u vandalizua në fshatin Vapila, Komuna e Ohrit. Në prill persona të panjohur vandalizuan varrezat ortodokse në fshatin Bërnjarc, Komuna e Gazi Babës. Deri në fund të vitit, policia nuk identifikoi të dyshuarit në asnjë incident.

Në dhjetor, Komiteti i Helsinkit gjatë vitit regjistroi tetë incidente të fjalës së urrejtjes me një komponent fetar. Në një rast në nëntor, një individ postoi kërcënime kundër anëtarëve të KOO-së në uebfaqen "Ortodoksia e Lirë", duke kërkuar "shfarosjen kolektive dhe brutale" të tyre.

Fondi i Holokaustit, një OJQ, ka vazhduar të punojë me Ministrinë e Arsimit në një projekt për të trajnuar mësuesit të cilët do t'i mësojnë nxënësit e shkollave të mesme për Holokaustin dhe historinë hebraike.

Në Mars, Qendra përkujtimore e Holokaustit hapi zyrtarisht ekspozitën e saj të përhershme që kap vlerën e disa miliona dollarëve, duke përkujtuar popullsinë hebraike të Maqedonisë së Veriut dhe 7.1148 hebrenjve të dërguar në kampin e vdekjes në Treblinka gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ashtu si vitet e kaluara, Qendra kreu programe të edukimit të Holokaustit në partneritet me Ministrinë e Arsimit.

Në maj, Papa Françesku vizitoi Shkupin dhe u takua me presidentin e atëhershëm Gjorge Ivanov dhe liderët e tjerë politikë, shoqërinë civile, udhëheqësit fetarë dhe rininë. Ai vizitoi Memorialin Nënë Tereza dhe mbajti një

Meshë ku morën pjesë rreth 15,000 persona. Papa Françesku vlerësoi harmoninë midis të krishterëve ortodoksë dhe muslimanëve në vend, si dhe mikëpritjen që u kishte bërë refugjatëve nga Lindja e Mesme. Ai tha se shembulli i vendit tregon që bashkëjetesa paqësore eshtë e mundshme mes diverzitetit të pasur.

Pjesa IV Politika qeveritare e Shteteve të Bashkuara

Ambasadori dhe zyrtar të qeverisë amerikane patën takime me përfaqësues të qeverisë, përfshirë Ministrin e Punve të Brendshëme Oliver Spasovski, Ministren e Drejtësisë Renata Deskoska dhe Zëvendës Kryeministrin e Qeverisë të angazhuar për Çështjet Evropiane Bujar Osmani ku u diskutuan çështjet e lirisë dhe tolerances fetare, përfshirë bashkëpunimin e përmirësuar ndërfetar dhe respektimin nga ana e qeverisë dhe trajtimin e barabartë të grupeve fetare. Ambasadori gjithashtu diskutoi me udhëheqësit fetarë tolerancën ndërfetare dhe rëndësinë e dialogut të hapur me grupet e besimit.

Në tetor, gjatë vizitës në vend Sekretari i Shtetit u takua me Kryepeshkopin Stefan dhe dy peshkopë të KOM-it.

Zyrtarë të ambasadës u takuan me liderin e BFI-së Rexhepi dhe Kryepeshkopin Stefan për të diskutuar çështjet e lirisë fetare, përfshirë akuzat e ndërhyrjes së grupeve fetare në lëndët gjyqësore (si për udhëheqësinë e BFI-së) dhe në zgjedhje, si dhe favorizmin nga qeveria të disa grupeve fetare.

Zyrtarët e ambasadës gjithashtu u takuan me përfaqësues nga shumë grupe fetare të pakicave, duke përfshirë bektashinjtë, hebrenjtë dhe pakicat krishtere, si dhe me OJQ që merren me çështjet e lirive fetare.

Ambasada financoi pjesëmarrjen e tre mësuesve në një akademi verore ndërkombëtare në Berlin, e cila ndër të tjera u përqëndrua në temën e edukimit për Holokaustin dhe historinë hebraike të shekullit XX.

MAQEDONIA E VERIUT

Në partneritet me Fondin e Holokaustit, ambasada gjithashtu i mbuloi shpenzimet për 40 mësues nga Ballkani Perëndimor (30 nga Maqedonia e Veriut dhe 10 nga Serbia, Sllovenia, Kroacia, Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina) për të marrë pjesë në një seminar organizuar në Shkup mbi marrëdhëniet ndërfetare që u realizua në tetor. Seminari përfshiu ligjerata mbi historinë, punëtori për krijimin e plan-programeve mësimore dhe projekteve ndërkokulturore, një vizitë sinagogës më të vjetër jashtë Izraelit që gjendet në lokalitetin arkeologjik Stobi, si dhe vizitë në ekspozitën e përhershme të Qendrës përkujtimore të Holokaustit.

Në tetor ambasada sponsorizoi vizitën e tetë drejtuesve fetarë dhe përfaqësuësve të shoqërisë civile në Shtetet e Bashkuara për të marrë pjesë në një program ku u takuan me përfaqësuesit e mendimit për të diskutuar lirinë fetare, diversitetin fetar, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe rolin e narrativave fetare. Grupi përfshinte përfaqësues të KOM-it dhe BFI-së, të komunitetit hebraik dhe bektashian, të metodistëve evangjelistë, si dhe të shoqërisë civile.

Ambasada postoi 14 mesazhe në mediat sociale në lidhje me lirinë fetare duke arritur në më shumë se 70,000 ndjekës. Temat përfshinin porositë e Sekretarit të Shtetit për rëndësinë e mbrojtjes së lirisë fetare dhe shënimin e Ditës Ndërkombëtare për Përkujtimin e Viktimave të Akteve të Dhunës për motive feje a besimi.

.

MAQEDONIA E VERIUT